

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE  
"HAPPY HOUR" SH.P.K.**

Sipas Ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëria Tregtare" dhe Ligjit nr 9723 i 03.05,007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" themelohet sot në datën 20.01.2020, shoqëria "Happy Hour" shpk. Adresa e shoqërisë është Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Aqif Pasha", ndërtesa nr.1 Elbasan, me ortak të vetëm Zj. Dorina Tafa

**VENDOSI:**

Krijimin e një shoqërie tregtare me emrin "Happy Hour" shpk me kushtet e mëposhtme:

**Neni 1**

Themeluesi, krijon shoqërinë tregtare "Happy Hour" shpk, me një statusin ligjor të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit nr 9901 të 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me burimet e veta financiare dhe kontributet e paguara në cash dhe në natyrë.

**Neni 2**

Kompania gëzon statusin e personit juridik dhe aktivitetet e saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi, sipas këtij akt themelimi dhe Statutit të aneksuar.

**Neni 3**

Kompania do të ushtrojë biznesin e tij nën emrin "Happy Hour" shpk dhe ky emertim do të shënohet në të gjitha dokumentet, letrat, faturat, etj.  
Kompania ka vulën e vet në të cilën është shkruar "Happy Hour" shpk Elbasan, Shqipëri.

**Neni 4**

Selia e kompanisë është e vendosur në Elbasan, Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Aqif Pasha", ndërtesa nr.1, Elbasan.

Kompania ka kompetenca të hapë dhe të mbyllë agjencitë e tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

**Neni 5**

Periodha e aktivitetit të kompanisë do të jetë i pakufizuar, përveç në rastet kur ortakët i vetëm



vendos shpërbërjen me te hershme e aktivitetit.

#### Neni 6

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt: Lokal, shërbim dhe informacion turistik etj..

#### Neni 7

Me vendim të themeluesit, kompania mund të ndryshojë emrin, vendin, statusin ligjor dhe qëllimin e punës, mbasi të deklarojë ndryshimet në këtë akt dhe në statutin e saj.

#### Neni 8

Kapitali i kompanisë i paguar plotësisht në mjete monetare është caktuar fillimisht nga ortakët i vetëm në masën 10 000 (dhjetemijë) leke.  
Kapitali shoqërisë përbehet nga një kuotë e cila zotërohet nga ortakët i vetëm i saj Zj. Dorina Tafa

#### Neni 9

Kompania zhvillon biznesin e saj për të bërë fitime. Ajo është përgjegjëse për detyrimet që ka ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë, që nga themelimi i saj.

#### Neni 10

Kompania kryen aktivitetin e saj administrativ, ekonomik e financiar, në përputhje me legjislacionin aktual dhe me statutin e bashkangjitur.  
Drejtimi i shoqërisë do të bëhet nga organet e saj drejtuese, të cilat përbëhen prej administratorit të saj.  
Ortakët i vetëm marr vendim për emërimin e ekspertit kontabil.  
Kompania do të mbajë llogaritë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe do të krijojë një fond rezervë.  
Fitimi neto që do të rezultojë në fund të çdo viti financiar, pas zbritjes së fondit rezervë dhe humbjeve të rezultuara nga vitet e mëparshme, do të shpërndahet ortakeve.

#### Neni 11

Përcaktimi i strukturës organizative të kompanisë, funksionet, dhe dorëheqja e organeve të tij merren nga organet drejtuese.  
Administratori i shoqërisë "Happy Hour" shpk do të jetë Zj. Dorina Tafa, ortak i vetëm i shoqërisë.



Marrëdhëniet e Punës, do të bazohen në kontratat e punës, dhe në ligjin përkatës.

## Neni 12

Rregullat për menaxhimin, organizimin dhe prishjen e shoqërisë, janë përcaktuar në statut që është bashkëngjitur në këtë akt themelimi.

Ortaku i vetëm i shoqërisë “Happy Hour” shpk

Dorina TAFA

